



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIĆIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIĆ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.01.2026, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishëm të tjerë: Drejtorët komunal dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti financiar i shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025
4. Raporti i Performancës së Komunës për vitin 2024
5. Dhënia në debat publik e Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
6. Plotësimi i Komitetit për komunitete
7. Shqyrtimi i Propozimvendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal
8. Plotësim ndryshimi i Rregullores nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale
9. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve të kompanisë KRM "Pastrimi"
10. Raporti i Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2025
11. Shqyrtimi i kërkesave
12. Të ndryshme

Kryesuesi—Injoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Raportin financiar të shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025 dhe për një shpjegim rreth kësaj çështje fjalën ia dha drejtorit të DEFZH-së.

Besnik Krasniqi – Propozoj që të mbetet shpjegimi për mbledhjen e Kuvendit, kur edhe merret vendim pasi që unë nuk kam qenë gjatë vitit të kaluar.

Kryesuesi – Ne e kuptojmë sepse në këtë fazë ju nuk e keni mbulu këtë drejtori, megjithatë, për shkak të performancës, Komuna do të ketë vazhdimësi.

Fjolla Nasufi – Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Edhe ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës ti rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal raportin financiar të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025.

Pika 4 e rendit të ditës Kryesuesi – Paraqiti Raportin e Performancës së Komunës për vitin 2024 dhe për një shpjegim rreth kësaj pike, fjalën ia dha drejtoreshës të administratës së përgjithshme.

Ariana Grajqevci – Prezentimi i raportit të performancës në Kuvendin Komunal është obligim ligjor dhe si qëllim kryesor e ka informimin e asambleistëve për rezultatet që ka pasë Komuna jonë, nga ky raport dhe informatat shtesë mund të jepen në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi – Pyeti viti 2024 a është rregull që bëhet raporti për këtë vit.

Ariana Grajqevci – Përgjegjet po, është rregull se të dhënat janë për vitin 2024.

Fjolla Nasufi – Edhe për këtë pikë të rendit të ditës jemi dakord që të kaloj për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Edhe ne jemi për që kjo pikë e rendit të ditës ti rekomandohet Kuvendit Komunal për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim Raportin e performancës për vitin 2024.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga DAP për dhënien në debat publik të Draft Kodit Etik, për zyrtarët e Komunës së Obiliqit, dhe për një shpjegim rreth kësaj pike fjalën ia dha drejtoreshës të administratës së përgjithshme.

Ariana Grajqevci – Komisioni e ka përgatitur Draft Kodin Etik dhe ky Draft është parashtruar më heret dhe miratuar, kështu që mund të bisedohet më konkretisht kur janë prezentë edhe anëtarët e Komisionit, të cilët e kanë përpiluar këtë Draft. Duke ditur se nga mandatet e kaluara ka pasë disa ndryshime atëherë ato ndryshime do ti paraqesim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – Ky Draft është miratuar në njërin prej seancave në vitin 2023 dhe tash ka rekomandim që me ndryshime të caktuara përsëri të kaloj në Kuvend.

Fjolla Nasufi – Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit Komunal.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Faleminderit kryesues, për sqarime sepse edhe ju keni qenë prezentë kur Ministria e Punëve të Brendshme veç i ka dhënë rekomandimet në lidhje me Kodin etik, dhe ne jemi për atë që t'i rekomandohet Kuvendit Komunal për debat publik.

Kryesuesi – Ne ishim pak në dyshim se a mund të shkoj përsëri në debat publik dhe unë ju rekomandova se mund të vjen ndonjë arsyetim apo diçka më e mirë nga debati publik, sepse duke qenë se është miratuar një herë dhe ka kaluar procedurën e debatit publik kemi qenë pak në dyshim si të veprojmë. Mirëpo në këtë rast nuk bën dëm asgjë nëse shkon në debat publik.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Çdo Rregullore është mirë paraprakisht, nëse ndryshohet edhe një shifër të kaloj përmes debatit publik, sepse këtu do t'i hiqen pikët Komunës në bazë të performancës, kështu që çdo gjë është mirë të kaloj përmes debatit publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe aprovim, kërkesën nga DAP-ja për dhënien në debat publik të Draft- Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Edhe në seancën e fundvitit, është formuar Komiteti kemi shpjeguar se Komiteti për komunitete plotësohet me anëtarë tjerë dhe e kemi marrë një shkresë nga MAPL-ja, e cila na i ka treguar format si të plotësohet ky komitet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal plotësimin e Komitetit për komunitete.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Propozimvendimit për Planin e punës të Kuvendit Komunal. Këtë Plan e kanë punuar, Grupi punues i zgjedhur nga Kuvendi Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Propozimvendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal.

Pika 8 e rendit të ditës.

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën nga DEFZH-ja, për plotësim ndryshimin e Rregullores nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale dhe për një shpjegim konkret fjalën ia jep drejtorit të DEFZH-së.

Besnik Krasniqi - Në këtë Rregullore faja 57 tabela nr.2 taksat komunale administrative pika 18 inspektimet e ndryshme, kërkesë personat fizik që ka qenë deri më tash me pagesë, ne mund ta bëjmë papagesë sepse nuk duam të i'u krijojmë një barrierë qytetarëve për të bërë ankesa të ndryshme në mënyrë që me qenë sa më transparente.

Kryesuesi – Ju kërkon vetëm një ndryshim të një çmimore tabela nr.2 në radhitje pika 18 nga çmimi që ka qenë 10 euro për qytetarët të cilët dëshirojnë të raportojnë një parregullësi që deri më tash ka qenë me pagesë ndërsa, ju rekomandoni që këtë pjesë ta ndryshojmë dhe ta bëjmë papagesë ose me një pagesë tjetër.

Besnik Krasniqi - Në seancën e Kuvendit më konkretisht do të ua sqarojmë.

Fjolla Nasufi – Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në seancën e radhës të Kuvendit Komunal dhe ndoshta kishte me qenë mirë të detajohet çmimi sa më i ulët, por sido që ta shihni të arsyeshme.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Shumë mirë që të paktën na dha pak sqarime drejtori, sepse në kërkesë është shumë boshe ku kërkohet vetëm të futet në rend dite. Unë madje e kam përcjellë edhe Rregulloren dhe në Rregullore nuk është e nënvizuar asgjë kështu që nuk kemi kuptuar se çfarë dojnë me ndryshue, ku dojnë me ndryshue dhe a është në rregullë me ligjin, por gjithsesi jemi që ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

Kryesuesi – Duke qenë se kemi shpjegime kërkojmë që në seancën e Kuvendit të jeni prezentë të na shpjegoni saktë çmimin dhe çkado që doni të ndryshoni.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Plotësim Ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02/2024 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale me nr.01-060-01-9738-24, të dt.04.04.2024.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të kompanisë KRM Pastrimi.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për, ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të kompanisë KRM Pastrimi.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti Raportin e punës të Kuvendit Komunal për vitin 2025. Të gjithë e dini se si kryesues i Kuvendit nuk është që kam pasë ndonjë obligim për punën e vlefshme të kryesueses që e ka bërë paraprakisht, megjithatë, qysh e thamë të raporti financiar institucionet duhet me pasë vazhdimësi për çështje të transparencës. Me atë që kemi mund me marrë të dhëna jemi munduar me i përfshi të gjitha ato që janë bërë dhe shfrytëzoj rastin ta falenderoj kryesuesen për gjithë kontributin e dhënë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e punës të Kuvendit Komunal për vitin 2025.

Pika 11 e rendit të ditës

Kryesuesi – Ne kemi pranuar tri kërkesa nga qytetarët dhe ajo që kam dashur unë të ndryshoj është se në momentin që na vjen një kërkesë edhe pse qytetarët gabimisht e kanë orientuar te ne, ju dërgoj Drejtorive përkatëse, në mënyrë që në afat rekord t'i japim përgjigje për kërkesat e caktuara se a ka mundësi me i realizue apo jo.

Kërkesa e parë është nga Nic Home SH.P.K. që ka kërkuar ndryshimin e pronarit. Ne ia kemi dërgue DPUKP-së për shqyrtim e cila tha se në parim mund të bëhet ky ndryshim por ne kemi kërkuar të japin një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Abdyrrahman Krasniqi – Ne kemi kërkesa që duhet të shqyrtohen dhe aprovohen në Kuvend dhe kemi kërkesa që japim vetëm përgjigje dhe në këtë rast kjo kërkesë duhet të votohet për Kuvend, ndërsa pjesën tjetër mundemi vetëm si përgjigje me ua kthye dhe këtë e vlerësoj.

Vlora Mjekiqi Kabashi - E vetmja mundësi ligjore për shqyrtimin e kërkesës tuaj mbetet posedimi i saj përmes Kuvendit Komunal, përmes një aneks kontrate apo vendimi tjetër përkatës, i cili duhet të jetë në përputhje me procedurën ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale. Kontrata me nr. të protokollit 2-420 e dt.14.05.2021 pika 5 neni 9 thuhet operatori ekonomik mund të përdorë pronën vetëm për qëllime të përdorimit të përshkruar sipas ofertës të negociuar dhe për të gjitha qëllimet tjera të nevojshme për realizimin e qëllimeve të parapara në projektpropozim. Nëse, nuk keni harruar z.kryesues ne e kemi pasë konkretisht një çështje të tillë me një x operatorë dhe kontratat e negociuara, apo ofertat e negociuara nuk ka të drejtë Kuvendi Komunal ti ndryshoj sepse negociatori kryesor është Kryetari. Kryetari bën aneks kontratë pastaj ai e sjellë në Kuvend për shqyrtim kështu që kjo nuk besoj se është ligjore. Kuvendi nuk mund të bëjë gjëra të tilla sepse është ofertë e negociuar Kryetari ka ofertue me operatorë, e jo Kuvendi Komunal.

Kryesuesi – Unë nuk thashë që të bëjmë miratim direkt por drejtorët deri atëherë kanë kohë me na dhënë një arsyetim. Kjo është e saktë që ju po e thoni, e di se ashtu është dhe unë kam me iu ndihmue drejtorëve të linjave me këtë përgjigje që ne e kemi. Mirëpo, nuk do të thotë direkt me u bë një miratim apo një ndryshim por të paktën ndaj kërkesave të qytetarëve ta kemi një përgjigje në mënyrë që qytetarët të ndahen të kënaqur me përgjigje edhe atëherë kur nuk ka mundësi diçka me u realizue sepse shumë herë kërkesat e dikujt mund të jenë të perealizueshme.

Abdyrrahman Krasniqi – Është e vërtetë se Kryetari negocion, por Kuvendi është ai që i jep dhe miraton pronat në shfrytëzim. Ky është vetëm një plotësim ndryshim dhe ka të drejtë të bëhet nga Kuvendi nëse e shehë të arsyeshme sepse ka biznese për shembull që e marrin pronën në shfrytëzim për 99 vite dhe gjatë kësaj kohe mundet me pasë ndryshime dhe plotësime. Ne jemi ata që e shohim të arsyeshme bazuar në arsyetimin e Drejtorisë dhe biznesit. Mendoj se është e ligjshme dhe Kuvendi e bën, bëhet vetëm një plotësim ndryshim do të thotë shtimi i një veprimtarie dhe mundet me qenë edhe te ndryshimi i aksionarëve apo pronarëve. Ligji e lejon, por nuk e di saktë cili ligj.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Unë nuk thashë se Kuvendi nuk ka të drejtë por Kryetari e sjellë në Kuvend e Kuvendi e shqyrton dhe aprovon sepse ne e kemi pasë në vitin e kaluar që nuk dua ta potencoj emrin e x operatorit dhe Ministria na e ka kthye si të kundërligjshme, ka thënë është ofertë e negociuar përmes Kryetarit dhe nuk kemi pasë asnjë dëshmi prej Kryetarit të cilën është dashtë me votue.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7, vota për ia rekomanduan DPUKP-së kërkesën nga Nic Home SH.P.K. dhe DPUKP të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi - Kërkesa e dytë është nga Halit Pllana për një aktivitet të përvitshëm të ushtarëve të UÇK-së, me dt.7 mars por meqë me 7 mars është ramazan ka kërkuar të mbetet me dt.17 shkurt kur është edhe përvjetori i pavarësisë së Republikës së Kosovës. Ai ka bërë kërkesë në 2 drejtime për mbështetje financiare për ushqim e pije dhe kërkesë tjetër që të mbështeten me një tendë me tavolina dhe karriga. Sa i përket kërkesës së parë e kemi shpjegimin nga drejtori i DEFZH-së se nuk është e mundur mbështetja financiare për personin fizik nëse nuk vjen prej organizatës, ka rekomandue që kërkesa të vjen prej OJQ-së, ose OVL-

së së UÇK-së. Sa i përket tendës Komuna na ka kthye përgjegje se nuk ka mundësi të siguroj diçka të tillë. Unë nga vullneti i mirë kam bërë kërkesë në Ministrinë e mbrojtjes dhe kam kërkuar ti ndihmoj këtyre organizatorëve por ende nuk kam marrë përgjegje. Pra, kërkoj nga Drejtoritë e linjave që në seancën e Kuvendit të na japin një shpjegim të saktë se si duhet të veprojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota ia rekomanduan DEFZH-së kërkesën nga Këshilli organizativ i manifestimit të përvitshëm të ish ushtarëve të UÇK-së dhe DEFZH-ja, të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi - Kërkesa e tretë është nga Muhamet Preniqi që në fakt qytetarët e caktuar kanë kërkuar prej tij mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Unë kam kërkuar nga DSHMS-ja, të na japë një përgjegje të cilën ende nuk e kemi.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për kërkesën nga Muhamet Preniqi ia rekomanduan DEFZH-së që së bashku me DSHMS-në, të vjen me një shpjegim në seancën e Kuvendit Komunal.

Pika e 12 e rendit të ditës

Kryesuesi – Pasi që nuk kemi diskutime në këtë pikë të rendit të ditës atëherë, edhe e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35'

Zyrtare e lartë për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesues i Komitetit


Sami Ahmeti

